



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 108 dt.31.07.1995

PER
ORGANIZIMIN E ÇERDHEVE TE FEMIJEVE

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Shëndetsisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit lidhur me zbatimin e udhëzimit të K.M. Nr.1, dt.02.05.1995 “Për normat e vendosjes së personelit në çerdhe dhe në këtë kuadër për organizimin e disa çerdheve të qytetit të Tiranës”.

Vëren se :

Në bazë të udhëzimit të mësipërm disa çerdhe të qytetit të Tiranës nuk i plotësojnë kushtet për të funksionuar mbasi kanë punonjës mbi normat e caktuar dhe fëmijë nën normat e caktuara. Në këto kushte me qëllim që të sigurojnë një organizim të mirë të çerdheve të Tiranës në zbatim të Udhëzimit Nr.1, dt.02.05.1995 dhe në bazë të ligjit “Për organizimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992 (neni.14, pika.13 dhe 21), Këshilli i Bashkisë Tiranës.

VENDOSI

1. Të nxirren në asistencë edukatorët dhe punonjësit e shërbimit (sanitare, rrobalarëse, nd/guzinjere) të cilat janë mbi normat e caktuara në këtë udhëzim.
2. Të mbyllen çerdhet Nr.3 dhe Nr.6 (në godina private), për shkak të frekuentimit nën normativë.
3. Të mbyllen çerdhet te Bregu i Lumit dhe ajo Nr.23 (godinë shtetërore) për shkak të frekuentimit të pamjaftueshëm, nën nivelin e kriterëve të udhëzimit Nr.1, dt.02.05.1995, për normat e vendosjes së personelit të çerdheve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Shëndetsisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve si dhe organet e tjera të administratës në mvarësi të Bashkisë të cilët lidhen me këtë veprimtari.

KRYETARI

BESNIK PETRELA